Republika e Kosovës
Republic of Kosova

Komuna Hani i Elezit
Municipality of Hani i Elezit

# RAPORT MBI PUNËN E DREJTORIS SË SHËRBIMEVE PUBLIKE DHE EMERGJENCË CIVILE PËR VITIN 2010

**Hani i Elezit, 2010**

# SHËRBIMET PUBLIKE

Drejtoria e Shërbimeve Publike ka punuar në sistemimin dhe rregullimin defekteve të ujësjellësit që i cili ka pas shumë probleme gjatë viteve të me hershme. Jemi munduar që qytetaret të kenë me shumë ujë nga sistemi i ujësjellësit, që vite me radhe ka pasur mjafte probleme me furnizim të ujit.

a) Në fazën e gjashtëmujorit të pare të vitit 2010 bërë e mundur që ujësjellësi i ri i Dimces të arrij në fazën finale- përfundimtare të instalimit të të gjithë mekanizmave dhe aparaturës për filtrimin e ujit.
b) Në fazën e gjashtëmujorit të dyte kemi rregulluar defekti e ujësjellësit në Glloboqice.

**Problemet sistemeve të ujësjellësit në Han të Elezit**

Me lëshimin pompave për filtrimin e ujit kemi vërejte se kemi humbje të mëdha të ujit. Kemi filluar me ç'kyçje të gypave të asbest-çimentos gypa të vjetër. Me ndihmën e CDI-së zvicerane e cila ishte edhe donator në ndërtimin fabrikës së ujit në Dimce kemi arritur që të bëjmë zvogëlimin e humbjeve të cilat i kishim më herët. Mirëpo duke pas parasysh se në qytetin e Hanit të Elezit ekzistojnë dy rrjeta të ujësjellësve njeri nga ujësjellësi i vjetër i asbest-çimentos dhe tjetri nga gypat e ri, humbjet ishin të mëdha për arsye se qarkullimit të ujit nëpër dy gypat dhe ndoshta edhe rrjedhjen e tij në ndonjë vend ende i pa njohur për ne. Aparatura e cila është vendosur në ujësjellësin e ri të Dimces është aparaturë moderne me standarde të Bashkimit Evropian me filtrim të ujit për **20 l/s**. Që nga fillimi i testimeve të ujësjellësit të ri te Dimces vërejtëm se ky kapacitet i ujit i cili filtrohet është i pa mundur që të furnizoj qytetin Hanit të Elezit, po ashtu qytetareve në pjesën e eperme të qytetit nga lagjja "Imri Curri" e më larte nuk furnizoheshin me uji andaj ishte edhe kërkesë e qytetarëve por edhe nga udhëheqja Komunale që të lëshohet uji pa filtrim që do të thotë jo i pijshëm , për furnizim të vazhdueshëm me ujë për qytetin ashtu si ka qenë viteve të më pashme. Humbjet në ketë rrjetë të ujësjellësit nga konstatimet tona janë qarkullimi i ujit nga rrjeta e re ne rrjetën e vjetër të ujësjellësit por duke mos përjashtuar edhe faktoni njeri që do të thotë keqpërdorimi i ujit.

Si problematik vlen të theksohet edhe mbyllja (bllokimi) i,e gypit në Glloboshice gyp i nxënë në qershore të 2010. Ne si drejtori kemi marr me urgjence për rregullimin këtij defekti të shkaktuar. Drejtoria e DHPE-së ka konstatuar se probleme i ndaljes së ujit është nxënia apo bllokimi i gypit me rrënje të barishteve dhe dëmtimi i gypit nga peshat. Me të ndërruar gypin me largësi 512 m (metra) sasia e ujit është shtua edhe për më shumë se sa ishte edhe viteve të kaluara. Mirëpo vlen të ceket se në kushte klimatike të nxehta munde të zvogëlohet sasia e ujit të Glloboqices po ashtu duke pas parasysh edhe faktorin njeri i cili benë keqpërdorimin ujit të pijshëm.

## ELEMINI I DEFEKTEVE NE UJESJELLES

Ne si Drejtori jemi munduar të rregullojmë apo eliminojmë defekte që kanë ndodhur në ujësjellësit e Hanit të Elezit. Numri i defekteve të eliminuara në ujësjellësit e Hanit të Elezit arrin në numrin 42 këtu duke i përfshire edhe eliminimin defekteve në Fushën e Seçishtës dhe në lagjen Maliq që të gjitha këto arrin numrin cekur më larte.

Po ashtu kemi bërë pastrimin kanalizimit atmosferik 3 herë gjatë këtij viti, duke mos harruar pa theksuar edhe atë të kanalizimit fekale.

**Inspektimet**

Drejtoria e Shërbimeve Publike me inspektorin e Komunës së Hanit të Elezit ka bëre inspektime të shumta prej të cilave do të përmendim:-
Inspektimin fabrikës së Sharr-Cem-it, ku ne kemi inspektuar për arsye të ndotjes së ambientit nga emri i cekur më larte, lende e cila është ndotur ambienti është azbest dhe se kemi pare që ndotja është bërë përgjatë Rekes së Dimces deri tek lumi Lepenc dhe se janë marre masat paraprake të parapara me ligj, nga inspektoret Komunal.
Kemi inspektuar edhe punët që janë bërë afër fabrikës së Okipor-it. këtu kemi vërejtur se pune kryerësi i cili ka kryer punët nuk është pajisur me leje përkatës për ndërhyrje në infrastrukture publike (rrugore). Ne kemi dalë në vendin ku ishin duke u kryer punimet dhe konform procedurave ligjore do të merren masat të mëtutjeshme.

**Kërkesat e qytetarëve të personave fizik-juridik në drejtorin e DSHPE-së**

Në gjashtëmujorin e parë Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencë Civile janë bërë 47 kërkesa të cilat kryesisht kanë të bëjnë me leje për kyçje në sistemin ujësjellësit dhe kërkesa të Shtëpisë së Zjarrfikëseve nga Hani i Elezit. Në gjashtëmujorin e dyte të vitit 2010 gjithsej kanë qenë 31 kërkesa po ashtu edhe këto kërkesa ka të bëjnë me kyçje në sistemin e ujësjellësit dhe një kërkesë për leje të prerjes së asfaltit. Numri i i përgjithshëm i kërkesave për vitin 2010 është 78.

- Kërkesa te miratuara janë 73
- Kërkesat jo te miratuara- te refuzuara janë 5.

Vërejtje:- kërkesat jo te miratuara janë ato kërkesa të cilat janë bere nga qytetaret mirëpo nuk janë lajmëruar për te marr përgjigjej, andaj nga kalimi afateve kohore të parashtrimit të kërkesave ato janë hedhur poshtë.

Gjatë kësaj periudhe Drejtoria ka paraqitur këto kërkesa

- Kërkesë për Ministrinë e ekonomisë dhe Financave MEF-in, për shtimin punëtoreve ne DSHPE.
- Kërkesë për kryetarin e komunës , për blerjen e një aparati digjital.
- Kërkesë për ministrinë e Ekonomisë dhe Financave MEFI-in, për themelimin një ndërmarrje publike komunale.

## TE HYRAT NGA DREJTORIA E SHERBIMEVE PUBLIKE

Të hyrat nga ujësjellësi në drejtorin e Shërbimeve Publike janë bere që te gjitha duke paguar shumën e caktuar prej 50 € (pesëdhjete euro) për kyçje në sistemin e ujësjellësit të Dimces dhe atë të Glloboqices.
Të hyrat në Drejtorinë DSHPE-së janë : **2,180** €.

## SHERBIMI I ZJARRFIKESVE –SHZSH-

Shërbimi i zjarrfikësve të Hanit të Elezit gjate vitit 2010 kanë lokalizuar 24 zjarre të cilat kanë përfshirë pjesë të ndryshme të qytetit tone dhe fshatrave për rreth. Nga këto intervenime të zjarrfikësve që të gjitha kanë qenë të suksesshme. Në rastet kur shërbimi i zjarrfikësve ka intervenuar për të lokalizuar zjarre, zjarret e përhapura kanë qenë zjarre të shkaktuara nga rryma elektrike dhe nga faktori njeri.
Po ashtu kemi pasur edhe disa ushtrime në teren, prej të cilave ushtrime në teren është ai në fshatin Seçishte në një pjese malore, ushtrimet në fshatin Gorance dhe ushtrimet tek varrezat e dëshmoreve në fshatin Puset e Nikes.
Vlen të theksohet edhe ndihmën të cilën shërbimi i zjarrfikësve ua ka ofruar qytetareve në Han të Elezit duke cekur atë për disa herë nga rritjet e ujit në përroit e Rezhances , po ashtu kanë kane ndihmuar në pastrimin kanalizimeve me ane të autocisternës.
Vlen te theksohet se ne te shumtën e intervenimeve zjarrfikësve te Hanit te Elezit i kanë dalë ne ndihme zjarrfiksat e Kaçanikut dhe ato të ndërmarrjes Sharr-Sallonit dhe Sharr-Cem për shkak të defekteve në kamionin e zjarrfikëse të Hanit të Elezit.

Ne vijim do të shihet raporti i SHZSH-së për vitin 2010

**PASQYRA E NUMRIT TE ZJARREVE NE OBJEKTE**

**NDERTIMORE –SIPERFAQJA E DJEGUR**

| SHZSH ë<br>KOMUNA HANI I ELEZIT | **Siperfaqja e djegur ne objekte ndertimore** | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | **Periudha: 01.01. - 30.11.2010.** | | | | |
| **V** | | Ne tersi | Pjeserisht | Shume pakë | |
| **I** | Banesaë shtep. | 1 | | 1 | |
| **T** | Obj. ndihmese | 2 | | | |
| **I** | Kulme | | | | |
| | Oxhaqe | | | | |
| **2** | Obj. publike | | | | |
| **0** | Obj. biznesi | | | | |
| **1** | Obj. industr. | | | | |
| **0** | Te tjera | | | | |
| | | | | | |

**PASQYRA E NUMRIT TE ZJARREVE NE SIPERFAQE TE HAPUR**

| SHZSH ë<br>KOMUNA HANI I ELEZIT | **Siperfaqja e djegur ( Hektar )** | | | |
|---|---|---|---|---|
| | **Periudha: 01.01. - 30.11.2010.** | | | |
| **V** | Mali | Bari I thate | Siperfaqe bujqesore | Te tjera |
| **I T I 2 0 1 0** | 5 | 6 | 0.5 | |

| | Pasqyra e numrit te pergjithshem te zjarreve janar - nendor 2010 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| KOMUNA HANI I ELEZIT | MUAJI 2010 | PASQYRA E ZJARREVE NE OBJ. NDERTIMORE | | | | | OBJEKTE EKONOMIKE | | | | MJETE TRANSPORT. | | SIPERFAQE TE HAPURA | | | | PAJISJE ELEKTRIKE | | | | GJITHESEJTE |
| | | Banes a shtep. | Obj. n dimese | Kulmet | Oxhaqe | Te tjera | Publike | Obj. Biznesi | Obj. Industr. | Te tjera | Mjete Motor. | *Int. tekn. rrug.* | Mali | Bari i that | Sip. bujq. | Te tjera | Pajisjet | Paj Sh perend. | Gjeneratora | Te tjera | |
| | janar | 1 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| | shkurt | 1 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| | mars | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| | prill | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| | maj | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| | qershor | | | | | | | | | | | | 1 | | | | | | | | |
| | korrik | | 1 | | | | | | | | | | | 5 | | | | | | | |
| | gusht | | 1 | | | | | | | | | | | 4 | | | | | | | |
| | shtator | | | | | | | | | | | | 1 | 4 | | | | | | | |
| | tetor | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| | nendor | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Gjithesejte: | | 2 | 2 | | | | | | | | | | 2 | # | | | | | | | 19 |

**PASQYRA E NUMRIT TE PJESETAREVE NE INTERVENIME ZJARRFIKESE DHE INTERVENIME TJERA, PER PERIUDHE KOHORE: JANAR - NENDOR 2010**

| SHZSH ë KOMUNA HANI I ELEZIT | PJESETAR | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | ShZSh | ShVZ | Qytetar | FSK | Te tjere |
| **VITI 2010** | | 106 | | 25 | | |
| | **Numri i orëve të Punës** | 232 | | 35 | | |
| | | | | | | |

**PASQYRA E MJETEVE TE SHPENZUARA PER SHUARJEN E ZJARRIT**
**PER PERIUDHE KOHORE: JANAR - NENDOR 2010**

| SHZSH ë KOMUNA HANI I ELEZIT | M J E T E T | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | Ujë ( m 3 ) | Shkumë ( Lit ) | Pluhur ( Kg ) | $CO_2$ ( kg ) | Te tjera |
| **VITI 2010** | 4.5 | | | | |
| | | | | | |

Hani i Elezit,
06.01.2010

Drejtori i DSHPE-se
Rufat Shkreta
_______________